



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/200
Datë: 18.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Zejtarisë.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade*

KONCEPT DOKUMENT

NË FUSHËN E ZEJTARISË

Shkurt 2024

Përmbledhje e koncept dokumentit	3
Hyrje.....	8
Tabela 1: Tabela me informata të përgjithshme lidhur me Koncept Dokumentin.....	9
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit.....	10
Tabela 2 : Dokumentet relevante të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore.....	13
Tabela 3: Pema e problemit që e paraqet problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij.....	26
Tabela 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit	29
Kapitulli 2: Objektivat	30
Kapitulli 3: Opsionet.....	31
3.1 Opsioni i parë është që të vazhdohet me zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore aktuale në fushën e zejtarisë.	31
3.2 Opsioni i dytë është ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore në fuqi;	31
3.3 Opsioni i tretë që parasheh ndryshime ligjore - hartimin e ligjit të ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit, i cili është edhe opsioni i rekomanduar.....	32
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në të ardhmen	34
4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	35
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....	36
Tabela 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të realizuara për koncept dokumentin.....	36
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	38
Tabela 8. Krahasimi i opsioneve	39
6.1. Plani i zbatimit për opsionin e preferuar	39
Tabela 9: Plani i Zbatimit për Opsionin 3:Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Ligjit për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit.....	40
Kapitulli 7: Përfundimi dhe hapat e ardhshëm	45
7.1: Dispozitat për monitorim dhe vlerësim.....	45
Aneksi 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik	46
Aneksi 2: Formulari i vlerësimit të ndikimeve sociale	49
Aneksi 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit mjedisor	53
Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit në të drejtat themelore.....	55

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informata të përgjithshme	
Titulli	Koncept dokumenti për fushën e zejtarisë
Ministria përgjegjëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Personi kontaktues	gurakuq.kastrati@rks-gov.net
PKZH	Koncept dokumenti është pjesë e PKZH 2023-2025: Aktiviteti nr.28
Prioritet strategjik	<p>Qëllimi zhvillimor - Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese</p> <p>Qëllimi strategjik - Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues</p> <p>Masa Strategjike - Përmirësimi i rregullatorit, unifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit</p> <p>Veprimi strategjik - Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për zejtarinë</p>

Vendimi	
Çështjet kryesore	<p>Ligji për Zejtarinë i miratuar në vitin 2004 nga IPVQ është një ligj i vjetërsuar dhe jo në harmoni me zhvillimet juridike, ekonomike dhe sociale nëpër të cilat ka kaluar Republika e Kosovës në dy dekadat e fundit. Në vitin 2021 me kërkesen e MINT-Departamentit Ligjor është realizuar vlerësimi EX-post nga USAID. Vlerësimi nuk është realizuar në përputhje me Udhërrefyesin për vlerësimin ekspost të legjislacionit në Republikën e Kosovës (2015) përshak të mosimpementimit të ligjit, andaj është përdorë alternativë tjetër metodologjike e cila është mbështetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Vlerësimin e dispozitave krahasuar me legjislacionin tjetër në fuqi në Kosovë, dhe</i> - <i>Krahasimi i ligjit me legjislacionin e vendeve të rajonit.</i> <p>Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar gjithashtu edhe intervista me akterët relevant për të krijuar një pasqyrë sa me të sakte mbi fushëveprimtarinë zejtare në Kosovë. Nga ky vlerësim kanë dalur këto konkluzione:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë tarifa uniforme për të gjithë zejtaret konsiderohen barrë administrative. Në mënyrë specifike, licencat shitesë, lejet, tarifrat dhe ngarkesat janë në kundërshtim me logjikën e krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e aktiviteteve të zejtarisë në Kosovë. - Përkufuzimi i zejtarisë si veprimtari tregtare në kuadër të ligjit është i paqartë, duke shkelur parimin e qartësisë në legjislacion, kapituj të tërë të Ligjit - si regjistrimi i biznesit dhe çregjistrimi/ndërprerja e veprimtarisë

janë të mbuluar me legjislacion të veçantë (*Ligji për Shoqëritë Tregtare*), përveç kësaj, dispozitat e tjera specifike të zëvendësuara, përfshijnë, ndër të tjera, kërkesat teknike dhe mjedisore, lejen e punës, aktivitetet e përbashkëta, arsimimin dhe zhvillimin profesional dhe organizimin e aktiviteteve zejtare.

- Ligji është i miratuar në periudhën e IPVQ, dhe këta mekanizma institucionalë kanë pushuar së ekzistuari. Ligji ka vendos përgjegjësi specifike mbi shoqatat e zejtarëve në nivel të vendit, i njëjti është i strukturuar dobët dhe krijon konfuzitet, i mungon koherenca dhe ka mangësi në shpjegimin e parimeve themelore, çka e bënë të vështirë të përcaktohet saktësisht kuptimin e veprimtarisë zejtare.

Andaj referuar kësaj që u cek më lartë, konsiderojmë se është e pamundur të realizohen qëllimet, objektivat strategjike dhe specifike në fushën e zejtarisë të përcaktuara me dokumentet relevante të Qeverisë, repsekivisht të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ligji i ri për zejtarinë do rregulloj veprimtarinë zejtare, kushtet për kryerjen e veprimtarisë zejtare, organizimin e sistemit të odës ekonomike, odave zejtare si dhe bazat e edukimit dhe aftësimin të personelit për nevojat e ushtrimit të veprimtarive zejtare.

Ligji gjithashtu ka për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e artizantit si veprimtari zejtare cila bëhet me bartjen e njohurive, aftësive të përgjithshme dhe aftësive artizanate. Me ligj do të rregullohet dhënia e titullit artizan, certifikimin e produkteve artizanate, emërtimin e industrive artizanate, nxitjen e veprimtarive dhe integrimin e subjekteve dhe të mjedisit mbështetës me zbatimin e masave për mbështetje financiare dhe masave tjera.

Përcaktimi i artizanatit si një veprimtari me rëndësi të veçantë shoqërore në interes të publikut me synim ruajtjen dhe zhvillimin e njohurive, aftësive dhe aftësive artizanate dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të cilat ndërlidhen me inovacionin i cili përfaqëson teknologjinë bashkohore është po ashtu një nga synimet kryesore të ligjit.

Ligji gjithashtu definon industrinë e artizanatit është një emërtim më i ngushtë i një lloji të vetëm të veprimtarisë zejtare, i cili karakterizohet nga një lloj i caktuar aftësish artizanate. Ministria dhe Oda Ekonomike e Kosovës do të përcaktojë listën e veprimtarive për artizanate

Ligji i ri dhe aktet nënligjore të cilat burojnë nga ky ligj kompletojnë një kornizë ligjore të qëndrueshme në fushën e zejtarisë dhe artizanatit e cila ka fokus promovimin e sigurisë, cilësisë dhe origjinalitetit të produkteve.

Përmbledhje e konsultimeve	<i>Koncept Dokumenti është dërguar për konsultim paraprak brenda institucioneve të Republikës së Kosovës gjatë periudhës 09-30.11.2023.</i>
	<i>Koncept Dokumenti është dërguar në konsultim publik dhe është vendosur në platformën e konsultimeve publike gjatë periudhës 01-22.12.2023.</i>
Opsioni i propozuar	<p>Ky koncept dokument rekomandon miratimin e Ligjit të ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit, si option i preferuar për arritjen e koherencës dhe efektivitetit të legjislacionit kornizë të Republikës së Kosovës në fushën e zejtarisë dhe industriisë së artizanatit.</p> <p>Opsioni 3 - Hartimi i Ligjit të ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit, është opsioni i duhur si politikë e veçant për t'i adresuar problemet dhe sfidat kryesore që rregullojnë fushën e zejtarisë dhe artizanatit të identifikuar në këtë koncept dokument dhe vlersimin Ex-post të Ligjit Nr.2004/44 për Zejtarinë.</p>

Ndikimet kryesore të pritura	
Ndikimi buxhetor	Buxheti për menaxhimin administrativ të secilit option duhet të mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.
Ndikimi ekonomik	Ligji do t'i shërbejë parimit të promovimit të rritjes ekonomike të qëndrueshme, duke siguruar dhe përmirësuar ofrimin e produkteve dhe shërbimeve zejtare dhe artizanate uniforme në funksion të permbushjes së kërkesave të tregut dhe konsumatorve, dhe rrjedhimisht duke e ruajtur konkurrencën e drejtë ndërmjet zejtarëve. Në përgjithësi, ligjet që rrethojnë zejtarinë dhe artizanatin synojnë të sigurojnë që këto produkte të jenë autentike, të sigurta dhe me cilësi të lartë. Kjo siguron që prodhuesit dhe konsumatorët të mbrohen dhe industria të vazhdojë të zhvillohet.
Ndikimi social	<p>Të drejtat e konsumatorit individual dhe familjar do të përmirësohen përmes zbatimit të rregullave të fuqizuara të cilat janë në nivelin e kërkuar të plotësisimit të kërkesave themelore (<i>siguria, shëndeti, mjedisi, prona</i>) nga ndërmarrjet zejtare.</p> <p>Ligji, përmes mekanizmave harmonizon kërkesat e tregut të punës me kualifikimet profesionale të fuqisë punëtore në sektorin e zejtarisë dhe gjithashtu do të njihen kualifikimet e marra në vendet tjera për këtë fushë.</p>
Ndikimet mjedisore	Ndikimi mjedisor i zejtarisë mund të ndryshojë në varësi të materialeve dhe teknikave të përdorura në procesin e prodhimit. Punimet e bëra nga materiale natyrore dhe të qëndrueshme si bambu, pambuku, leshi ose materiale të ricikluara mund të kenë një ndikim më të vogël në mjedis sesa ato të bëra nga materiale sintetike. Prodhimi i materialeve sintetike kërkon një sasi të madhe të konsumit të

	<p>energjisë, dhe procesi i prodhimit prodhon ndotje, degradon mjedisin dhe ndikon në shëndetin e njeriut. Teknikat e përdorura në prodhimin e produkteve artizanate mund të kenë gjithashtu pasojë mjedisore, p.sh, teknikat tradicionale të ngjyrosjes shpesh përdorin ngjyra natyrore që kanë më pak gjasa të ndotin mjedisin, ndërsa ngjyrat moderne sintetike kërkojnë përdorimin e kimikateve të dëmshme.</p> <p>Në përgjithësi, ndikimi mjedisor i zejtarisë mund të jetë pozitiv ose negativ në varësi të materialeve dhe teknikave të përdorura. Zgjedhja e materialeve të qëndrueshme, natyrore dhe metodave të prodhimit që minimizojnë mbetjet dhe ndotjen mund të kenë një ndikim pozitiv në mjedis.</p>
<p>Barra administrative për kompanitë</p>	<p>Intervenimet e parapara në Koncept Dokument, do të shkaktojnë kosto shtesë për ndërmarrjet zejtare, që do të ndërlihet me procesin e dhënies së licencave për veprimtari të caktuara zejtare si dhe të marrjen e titullit artizan/mjeshter, si dhe njohjen e lejeve dhe licencave nga vendet tjera. Për të zbutur efektet e barrës administrative, koncepti dokumenti parasheh që dizajnimi i këtyre procedurave do të jetë në linjë me kërkesat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA), sidomos sa i përket parimit të mos-pagesës dhe ofrimit të shërbimit me kohë. Gjithashtu, koncepti dokumenti parasheh lehtësim për aplikim, shqyrtim dhe lëshim të licencave dhe kualifikimit përmes digjitalizimit të shërbimeve, gjë që pritet të zvogëlojë barrën e panevojshme.</p> <p>Ligji i ri përcakton anëtarësim të detyrueshëm për subjektet zejtare dhe kuota për anëtarësimin në Oden Ekonomike të Kosovës të cilat janë të detyrueshme. Këto kuota do të klasifikohen në varësi të numrit të punëtorëve ose qarkullimit vjetor dhe veprimtarisë të subjektit zejtar. Shuma e kuotës së anëtarësimit do të shërbejë përfaqësimit të interesave dhe përmirësimit funksionimit të subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtari zejtare.</p>
<p>Ndikimi në NVM-të</p>	<p>Kompletimi i kornizës ligjore në fushën e zejtarisë dhe artizanit do të ketë ndikim pozitiv duke rritë konkurrencën të subjektet zejtare për shkak të organizimit të përmirësuar dhe mbikëqyrjes së fuqizuar tek ndërmarrjet zejtare të cilat ofrojnë produkte dhe shërbime në fushën e zejtarisë dhe artizanit.</p> <p>Zhvillimi i zejtarisë do të ketë ndikim pozitiv në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kjo përfshinë edhe aftësimet profesionale, por edhe mundësisë së zhvillimit të bizneseve të sektorit të zejtarisë, duke përfshirë prodhimin, dhe ofrimin e shërbimeve në këtë fushë.</p>

Hapat e ardhshëm

Afatshkurtër	<p>1. Hartimi i Ligjit për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit</p> <p>Marrë për bazë rekomandimin kryesor të këtij koncept dokumenti (hartimi i ligjit të ri për për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit), me miratimin e koncept dokumentit, MINT do të ndërramarrë hapat e nevojshëm për zbatimin e opsionit të rekomanduar.</p>
Afatmesëm	<ol style="list-style-type: none">1. Hartimi i Rregullores për veprimtaritë zejtare;2. Hartimi i Rregullores për procesin e lëshimit të licencave zejtare dhe regjistrin zejtar;3. Lista e veprimtarive/aktiviteteve zejtare për të cilat nuk kërkohet licencë,4. Lista e programeve përkatëse të arsimit të mesëm dhe kualifikimeve profesionale kombëtare për kryerjen e veprimtarive zejtare individuale;5. Hartimi dhe zbatimi i Programit për ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit;6. Themelimi i njësisë së vecantë për zejtarinë në Odën Ekonomike të Kosovës7. Themelimi i Këshillit për Zejtarinë i cilin përfaqëson odat zejtare në Republikën e Kosovës,8. Zhvillimi i platformës digjitale procesin e lëshimit të licencave zejtare dhe regjistrin zejtar;9. Informimi i vazhdueshëm i zejtareve përmes punëtorive, fushatave, spoteve televizive dhe takimeve publike.

Hyrje

Republika e Kosovës, aktualisht fushën e zejtarisë e ka të rregulluar me Ligjin nr. 2004/44 për Zejtarinë, i cili mbulon dimensione të ndryshme të veprimtarisë zejtare, duke përfshirë regjistrimin, ndërprerjen e veprimtarisë/çregjistrimin, arsimimin dhe zhvillimin profesional të zejtarëve, kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta zejtare, organizimin e subjekteve zejtare brenda shoqatave, si dhe mbikëqyrjen dhe dënimet për shkeljet. Megjithatë, vlerësimi Ex-post ka konfirmuar që ligji nuk është zbatuar nga institucionet përkatëse për shkak se paqartësive ligjore, mungesës së akteve nënligjore dhe mungesës së mekanizmave përgjegjës për zbatim.

Legjislacioni i miratuar për një periudhe kohore të gjatë afër dy dekada, në raport me rrethanat e ndryshuara të organizimit institucional të vendosur kryesisht para shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në rrethana tjera politike, juridike, ekonomike, shoqërore, ka bërë që në mënyrë sistematike të rriten defektet rregullative si dhe vështirësitë në implementimin e politikave publike që nxisin zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Kosovës.

Fakti që Ligji për zejtarinë është i pa zbatueshëm, përveq që konfirmohet me vlersimin Ex-post, konfirmohet edhe nga referencat e tij në mekanizmat institucionalë që kanë pushuar së ekzistuari ose nuk janë krijuar ndonjëherë.

Sa i përket nivelit të përfrimit të legjislacionit me BE, nuk ka legjislacion të harmonizuar i cili rregullon fushën e zejtarisë, pra të gjitha vendet e BE-së e kanë të rregulluar këtë fushë me dispozita kombetare, përjashtuar çështjen e njohjes së kualifikimeve. Njohja e kualifikimeve rregullohet me Direktivën 1999/42/EC për njohjen e kualifikimeve profesionale për kryerjen e profesioneve të rregulluara. Gjithashtu do të njihen edhe profesionet të rregulluara të cilat mbulohen nga marrëveshjet multilaterale/bilaterale për njohjen e kualifikimeve dhe profesioneve e të cilat nderlidhen edhe me ligjin për shërbime.

Andaj, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e saj Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti i Ndërmarrësisë, është caktuar përgjegjës për hartimin e kornizës ligjore për fushën e zejtarisë, duke konsideruar jetike fushën e zejtarinë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe njohurive tradicionale. Teknikat e zejtarisë dhe artizanatit kalojnë nga një brez në tjetrin, duke siguruar vazhdimësinë e traditave. Megjithatë, artizanati gjithashtu përfaqon inovacionin, pasi artizanët bashkojnë aftësitë tradicionale me dizajnet, materialet dhe teknologjitë bashkëkohore. Ky bashkim ruan interesin për artizanat dhe e lejon atë të përshtatet me tregjet moderne.

Me datë 28 Mars 2023, me vendimim me numër të prot: 1616-02, përkatësisht ndryshimin dhe plotësimin e këtij vendimi, Sekretari i Përgjithshëm i MINT ka formuar grupin punues për hartimin dhe përfundimin e Koncept Dokumentit për fushën e zejtarisë.

Tabela 1: Tabela me informata të përgjithshme lidhur me Koncept Dokumentin

Titulli	Koncept dokumenti në fushën e zejtarisë
Ministria përgjegjëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Personi kontaktues	Gurakuq Kastrati, zv.Drejtor i Departamentit të Ndërmarrësisë
PKZH	Koncept dokumenti është paraparë me Plani Kombëtar për Zhvillim- PKZH 2023-2025: Aktiviteti Nr.28
Prioritet strategjik Qëllimi zhvillimor - Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese	Veprimi strategjik - Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për zejtarinë 1. Qëllimi zhvillimor - Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese 1.1 Qëllimi strategjik - Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues 1.1.1 Masa strategjike - Përmirësimi i rregullatorit, unifikimi dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit
Grupi punues	Përfaqësuesit e ministrive të linjës, agjencive ose profesioneve të mëposhtme: 1. Gurakuq Kastrati - kryesues; MINT 2. Igballe Rexha Jashari - anëtare; MINT 3. Remzije Hajdari - anëtare; MINT 4. Mevlyde Beqiri - anëtare; MINT 5. Muhamet Hashani - anëtar; MINT 6. Kastriot Vrella - anëtar; MINT 7. Shkurte Krasniqi, anëtare, ZKM 8. Kosovare Kelmendi - anëtare; MINT 9. Gent Berisha - anëtar; MINT 10. Liridona Hoti, anëtare - ZKM 11. Ryve Prekorogja, anëtare; MASHT 12. Dafina Kumnova; anëtare AKS
Informata shtesë	Hartimi i këtij Koncept Dokumenti është përkrahur nga SKQ/GIZ-Projekti mbështetje reformave të integrimit evropian, pjesa e barrës administrative.

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Ministrisa e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, shoqatet e bizneseve, subjektet zejtare dhe artizanate konstatojnë domosdoshmërinë e hartimit të një kornize të re të politikave publike në fushën e zejtarisë dhe artizanatit si veprimtari e veçantë zejtare, të cilat do të mundësojnë që kjo fushë e ndikimit të posaçëm në jetën shoqërore dhe ekonomike, të realizojë plotësisht potencialin e vet.

Me këtë koncept dokument, përmes shqyrtimit, vlerësimit dhe analizës së rrjedhës së deritashme të kuadrit të përgjithshëm rregullator, synohet të adresohet domosdoshmëria e një reforme të mirëfilltë, dhe rekomandimeve nga vlerësimi Ex-Post, do të mundësohet implementim i suksesshëm i politikave zhvillimore si dhe përdorimin efikas të të gjitha resurseve në drejtim të avancimit të mjedisit të përgjithshëm për zhvillimin e zejtarisë dhe artizanatit në Republikën e Kosovës.

Në përgjithësi, barra administrative e përcaktuar nga Ligji për Zejtari, konsiderohet si ngarkesë e tepërt për zejtarët, të cilët përgjithësisht karakterizohen me burime të kufizuara të kualifikimeve dhe burimeve njerzore. Në mënyrë specifike, licencat shtesë, lejet, tarifrat dhe ngarkesat janë në kundërshtim me logjikën e krijimit të një mjedisi të favorshëm për aktivitetin afarist në Kosovë.

Ligji aktual për Zejtari, bazohet në Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK, para shpalljes së pavarësisë.

Ligji mbulon zejtarinë prodhuese dhe zejtarinë shërbyese. Përveç kësaj, dispozitat e tij mbulojnë edhe zejtarinë artistike dhe artizanatet. Në këtë kontekst, ekziston një ndarje shtesë e aktiviteteve zejtare, në: zejtari të lirë/vullnetare/profesionale - zejtari që nuk kërkon kualifikim profesional ose provim kualifikues; zejtari e ndërlidhur - zejtari që kërkon kualifikim profesional ose kalim të provimit profesional; dhe zejtari ekskluzive - zejtari që kërkon autorizim të veçantë (d.m.th. leje nga MINT).

Sipas vlerësimit Ex-Post qellimi i Ligjit është i paqartë, duke shkelur parimin e qartësisë në legjislacion. Në Ligj përcaktohet se dispozitat burojnë nga nevoja për të "vendosur një sistem modern, me qëllim të mbrojtjes së zejtarisë si veprimtari e pavarur ekonomike dhe me qëllim të realizimit të fitimit në prodhim, qarkullim dhe shërbimeve në treg". Përkufizimi "mbrojtjes së zejtarisë si një veprimtari e pavarur ekonomike" është i paqartë.

Kushtet e vendosura me Ligjin për Zejtarinë, kërkesat teknike, kushtet e mjedisit, kërkesat shëndetësore dhe sanitare - për kryerjen e aktiviteteve të tilla janë të përshkruara në Ligjin për Tregtinë e Brendshme. Në fakt, Ligji për Tregtinë e Brendshme përcakton se njëri nga aktet nënligjore do të specifikojë: "kushtet minimale teknike, të cilat duhet të përmbushin lokalet afariste, pajisjet dhe mjetet me ndihmën e të cilave ushtrohet veprimtaria tregtare si dhe kushte të tjera, varësisht nga forma dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë tregtare".

Lidhur me kërkesat e tjera specifike në fushën e mjedisit, Kosova ka miratuar ligje të veçanta. Një nga to është ligji për mbrojtjen e mjedisit i cili përcakton kërkesa të veçanta për mbrojtjen e mjedisit.

Një kërkesë tjetër teknike për veprimtaritë zejtare ka të bëjë me nevojën për ambiente pune të mbrojtura nga zhurma, këto kërkesa përcaktohen me Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma.

Ligji për Zejtari u jep të drejtën të huajve që janë rezidentë në Kosovë që të ushtrojnë veprimtari zejtare. Megjithatë, kjo çështje është trajtuar në Ligjin për të Huajt, i cili rregullon “punësimin e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës”. Përveç kësaj Ligji për të Huajt merr përsipër edhe angazhimet që Kosova është zotuar si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në në lidhje me punësimin e qytetarëve të BE-së në Kosovë.

Ligji për Shoqëritë Tregtare përfshin emrin zyrtar dhe emrin tregtar të subjektit brenda procesit të regjistrimit. Këto çështje mbulojnë në Kapitullin IV “Emri zyrtar i shoqërisë tregtare dhe emri tregtar”, ndërsa rregullimi i çështjeve mbi emrin e subjektit dhe emrin tregtar janë specifikuar më tej në Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Regjistrimit të Emrit Zyrtar dhe Emrit Tregtar të Shoqërive Tregtare.

Pjesë e rëndësishme e kapitullit për regjistrimin e veprimtarisë zejtare ka të bëjë me lejen e punës për të kryer veprimtari zejtare. Nenet 10 deri në 13 mbulojnë procesin e lëshimit të lejes për lloje të ndryshme të veprimtarisë zejtare, duke përfshirë autoritetin lëshues, kushtet, refuzimin dhe procedurën ankimore.

Për më tepër, Ligji për Zejtari i referohet orarit të punës, listës së çmimeve, faturave, garancisë së cilësisë, standardeve të kontabilitetit, mjedisit të punës dhe kërkesave që subjekteve zejtare u kërkohet të respektojnë. Çështja e përcaktimit të orarit të punës është përgjegjësi e administratës lokale.

Lista e çmimeve, faturimi dhe siguria e produkteve të vendosura në dispozicion të tregut mbulojnë me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Ligjin për Sigurinë e Përgjithshme e Produkteve.

Lidhur me raportimin e pasqyrave financiare sipas standardeve dhe rregulloreve të kontabilitetit është e rregulluar me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Në fund, Ligji për Zejtari parashtron që subjekti zejtari duhet të krijojë mekanizma për të mbrojtur punonjësit nga çdo rrezik pune. Kjo fushë është rregulluar gjerësisht në Ligjin e Punës.

Ligji për Zejtari, vë theks të veçantë në organizimin e subjekteve zejtare në shoqata të biznesit. Legjislacioni aktual që rregullon lirinë e subjekteve - shoqërive tregtare apo të tjera - për t'u bashkuar në shoqata ose oda është i rregulluar me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe ky organizim i subjekteve zejtare, duhet të rregullohet sipas legjislacionit aktual në fuqi.

Veprimtaritë specifike zejtare kërkojnë certifikim. Sipas Ligjit aktual, procesi i certifikimit - mbi të cilin lëshohet leja e punës nga Komuna ose Ministria përkatëse - përcillet nga një program arsimimi profesional. Sistemi i arsimimit dhe aftësimin profesional të zejtareve duhet të mbështetet në mekanizmat ligjor dhe institucionalë që lidhen me arsimin formal dhe joformal në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, dispozita të tilla duhet të jenë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe legjislacionin përcjellës, përfshirë Ligjin për Kualifikimet Kombëtare dhe Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.

Këto dispozita nuk janë në përputhje me legjislacionin e ri siç është Ligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe Ligji për Profesionet e Rregulluara . Ligjin për Zejtari ka kundërthënie të theksuara me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, veçanërisht mbi llojet e lejeve të kërkuara për të operuar (leje ose licencë). Gjithashtu, Ligji është në kundërthënie me Ligjin për Profesionet e Rregulluara i cili përcakton profesionet për ushtrimin e të cilave kërkohet licencë profesionale dhe që nuk përfshin profesionin e Zejtarit në listën e profesioneve të rregulluara.

Andaj, duke pasur parasysh gjetjet e prezantuara, ku dispozitat e Ligjit mbivendosen me legjislacionin që ka të bëjë me regjistrimin e biznesit, tregtinë e brendshme, kërkesat teknike, licencat dhe lejet, lirinë e asociimit, kualifikimet profesionale, inspektoratin tregtar, trashëgiminë kulturore etj, MINT ka filluar procedurat për hartimin e Koncept Dokumentit për fushën e zejtarisë, i cili do të përfshijë identifikimin e problemeve, adresimi i të cilave kërkon ndërhyrje ligjore, me të cilat synohet ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues përmes hartimit të një ligji të ri i cili rregullon fushën e zejtarisë dhe artizanatit.

Ligji i ri do të ofrojë siguri ligjore për të gjithë zejtaret pjesëmarrës treg qoftë me produktet apo shërbimet e tyre zejtare apo artizanate, pasi ai përshkruan në detaje veprimet dhe kërkesat e tyre në lidhje me prodhimin, shërbimet, kualifikimin, certifikimin, dhe mbikëqyrjen në treg treg të produkteve dhe monitorimin e vazhdueshëm të si dhe aktivitetet dhe masat e marra për këtë qëllim.

Zbatimi i këtij ligji do të ndikojë ndjeshëm në parandalimin e konkurrencës jo të drejtë, sepse rregulla të barabarta dhe të qarta do të vendosen për të gjithë operatorët ekonomik në lidhje me prodhimin dhe tregtimin e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e zejtarisë. Zbatimi i ligjit të ri mund të rrisë kostot për operatorët ekonomik (analiza e rrezikut, informacioni i konsumatorit, monitorimi i tregut), këto kosto padyshim do të jenë të justifikuara dhe shumë më të ulëta se kostot e mundshme që mund të vijnë nga pasojat e dëmtimit të shëndetit të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë, të shkaktuara nga përdorimi i produkteve dhe marrja e shërbimeve të cilat mund të cenojnë kërkesat themelore.

Tabela 2 : Dokumentet relevante të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligji ose akti nënligjor	Lidhja me dokumentin online dhe me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucionet shtetërore Përgjegjëse për implementim	Roli dhe detyrat e institucionit(eve)
Marrëveshja për stabilizim dhe asociim	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_55-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf	Qeveria e Kosovës dhe ministritë e linjes	Roli i MSA është të mbështesë përpjekjet e Kosovës për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës; të kontribuoj në stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në Kosovë si për stabilizimin e rajonit; të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; të mbështesë përpjekjet e Kosovës për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse lejojnë rrethanat objektive, gjithashtu edhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së; të mbështesë përpjekjet e Kosovës për të përfunduar tranzicionin në një

			ekonomi funksionale të tregut; të promovojë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Kosovës; të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e trajtuara me këtë Marrëveshje.
PKZH 2023 - 2025		Qeveria e Kosovës dhe ministritë e linjes	
Ligji nr.2004/44 për Zejtari	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2418	Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ministritë tjera të linjës	Roli i këtij ligji është të rregulloj kushtet për ushtrimin e veprimtarisë zejtare si vijon: regjistrimi, afarizmi, ushtrimi i përbashkët, ndërprerja e veprimtarisë, aftësimi profesional, edukimi, organizimi zejtar, ruajtja dhe kultivimi i zejeve të vjetra dhe mbikëqyrja e veprimtarisë zejtare.
Ligji nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme,	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2473	Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ministritë tjera të linjës	Roli i këtij ligji është të rregulloj kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë në tregun e brendshëm, tregtia me shumicë, tregtia me pakicë, ankandi,

			ndërmjetësimi në tregti, praktikat kufizuese dhe masat mbrojtëse për ushtrimin e veprimtarisë tregtare, konkurrencën e pandershme, masat mbikëqyrëse, masat administrative dispozitat ndëshkuese dhe dispozitat përfundimtare.
Ligji Nr. 05/1-087 për Kundërvajtje	https://gzk.rks-gov.net/ActDocument/Detail.aspx?ActID=12839	Ministria e Drejtësisë	Roli i këtij ligji është rregulloj kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje.
Udhëzimi Administrative Nr. 2005/12 për Përbushjen e Kushteve Teknike Minimale për Lokalet Afariste, Objektet e Shitjes me Shumicë dhe Pakicë dhe për	https://gzk.rks-gov.net/ActDocument/Detail.aspx?ActID=7269	Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ministritë tjera të linjës	Roli i këtij udhëzimi është te përcaktoj kushtet minimale teknike të cilat duhet përbushur objektet afariste (në tekstin vijues: objektet), pajisjet dhe stabilimentet në objektet shitëse për tregti me pakicë dhe shumicë, ushtrim të ndërmjetësimin në tregti si dhe kushtet

Ndërmjetësim në Tregti,			për shitjen e mallit jashtë objekteve shitëse
Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit,	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues dhe ministritë tjera të linjës	Roli i këtij ligji është të harmonizohet zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian
Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma,	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2586	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues dhe ministritë tjera të linjës	Roli i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis. Ky ligj do të ofrojë bazë për krijimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanërisht ato rrugore, hekurudhore, ajrore, pajisjet e jashtme dhe

			industriale, makineria mobile dhe burimet tjera të ndotjes dhe bezdisjes së mjedisit nga zhurma.
Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare,	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426	Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe ministritë tjera të linjës	Roli i këtij ligji është përcaktimi i: llojeve të shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë ekonomike në Kosovë, subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, organizimit, kompetencave dhe funksioneve të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, kërkesave, kushteve dhe procedurave të regjistrimit dhe çregjistrimit, për secilin lloj të shoqërive tregtare; organizimit të shoqërive tregtare; dhe të drejtave dhe detyrimeve të aksionarëve, Përfaqësuesve të Autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në

			lidhje me Shoqëritë Tregtare.
Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt,	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8876	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	Roli i këtij ligji është rregullimi i kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës, Agjencia për Punësimin e në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm lidh kontrata të punësimit me punëmarrësit e agjencisë së përkohshme, me qëllim të caktimit të tyre për të punuar përkohësisht për ndërmarrjet nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e tyre;
Udhëzimi Administrativ nr. 02/2020 mbi Procedurën e Regjistrimit të Emrit Zyrtar dhe Emrit Tregtar të Shoqërive Tregtare,	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29614	MINT/ARBK	Roli i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave të regjistrimit, përdorimit, mbrojtjes dhe çregjistrimit të Emrave Zyrtar dhe Emrave Tregtar të shoqërive tregtare. është përcaktimi i procedurave të regjistrimit, përdorimit, mbrojtjes dhe çregjistrimit të Emrave

			Zyrtar dhe Emrave Tregtar të shoqërive tregtare.
Udhëzim Administrativ për Çregjistrimin e Bizneseve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve,	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35781	MINT/ARBK	Roli i këtij udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave të parapara për çregjistrimin e Shoqërive Tregtare apo subjekteve tjera të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (me tutje: ARBK).
Ligji nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave,	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967	Zyra e Kryeministrit dhe ministritë e linjes	Roli i këtij ligji është të vendos parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës.

<p>Ligji nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13072</p>	<p>MINT/ MASHTI</p>	<p>Roli i ketij ligji është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e profesionit të rregulluar që ka të bëjë me mbrojtjen e interesit publik. Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës janë profesionet të: Mjekut; Stomatologut; Farmacistit; Infermierit; Mamisë; Fizioterapeutit; Veterinerit; Arkitektit; Inxhinierit të të gjitha fushave; Mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar; Edukatorit; Psikologut; Punëtorit social; Pedagogut; Ekonomistit; Juristit</p>
<p>Ligji për Dizajnin Industrial</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/</p>	<p>Zyra e Kryeministrit dhe MINT</p>	<p>Roli i ketij ligji është te përcaktoj kushtet dhe procedurat për regjistrimin e dizajnit industrial, si dhe të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi, masat, procedurat dhe mjetet për zbatimin e të drejtave dhe Dizajnit Komunitar.</p>

Ligji për mbrojtjen e konsumatorit	https://gzk.rks-gov.net/	MINT dhe ministritë e linjes	Roli i këtij ligji është rregullimi i kushteve të tregut në marrëdhëniet biznes me konsumator, duke përfshirë etiketimin e produkteve, treguesit e çmimeve, shërbimet publike dhe praktikrat e padrejta tregtare; 1 të drejtat e konsumatorëve në lidhje me kontratat, duke përfshirë kushtet e padrejta të kontratës, shitjeve në distancë dhe jashtë mjedisit biznesorë, kontratave jo-komforë, kontratave të kredive për konsumatorë dhe kontratave të produkteve turistike; mbrojtjen administrative dhe gjyqësore të interesave të konsumatorëve; kuadrit institucional për mbrojtjen e konsumatorit në Republikën e Kosovës.
Legjislacioni në fuqi ATK	https://gzk.rks-gov.net/	Zyra e Kryeministrit dhe ministritë e linjes	ATK do të jetë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, Ligjin mbi Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjin mbi Tatimin në

			<p>të Ardhurat e Korporatave, Ligjin mbi Tatimin në</p> <p>Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në Kosovë e që i ngarkon detyrën</p> <p>të administrojë çdo lloj tatimi.</p> <p>Për të plotësuar përgjegjësinë e saj sipas paragrafit të këtij neni do të jetë detyrë e ATKsë të mbledhë gjatë kohës të hyrat që janë praktike përbrenda ligjit duke pas parasysht:</p> <p>3.1. burimet në dispozicion për ATK-në</p> <p>3.2. rëndësinë e ngritjes së përmbushjes, veçanërisht përmbushjes vullnetare, të legjislacionit tatimor të Kosovës nga të gjithë tatimpaguesit; dhe</p> <p>3.3. shpenzimet e përmbushjes të dala nga tatimpaguesit.</p>
Ligji per trashëgiminë kulturore	https://gzk.rks-gov.net/	Zyra e Kryeministrit dhe ministritë e linjes	Subjekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, të krijuara

		<p> gjatë shekujve, gjithashtu mjetet legale dhe teknike për inventarizim, dokumentim, selektimi mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të këtyre thesareve në pajtim me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje. Vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës. Ky ligj vendos marrëdhëniet midis pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore, qofshin ata individë ose komunitete ose autoritete publike - përgjegjës për vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Kjo gjithashtu do të krijojë përgjegjësitë e personave privatë dhe institucioneve publike në lidhje me </p>
--	--	---

			trashëgiminë kulturore.
Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve	https://gzk.rks-gov.net/	Zyra e Kryeministrit dhe ministritë e linjes	Roli i këtij ligji është që të sigurojë që produktet e vendosura në treg të jenë të sigurta. 2. Ky ligj përcakton kërkesën e përgjithshme të sigurisë për produktet, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, informimin e publikut, nxitjen/marrjen e masave vullnetare dhe mbikëqyrjen inspektuese për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara.
Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative	https://gzk.rks-gov.net/	Zyra e Kryeministrit dhe ministritë e linjes	Roli i këtij ligji është të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti

			administrativ, ose lidh një kontratë administrative, ose zbaton kompetencat e veta përmes akteve reale, që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave.
--	--	--	--

Tabela 3: Pema e problemit që e paraqet problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij

Problemi kryesor	Mungesa e një sistemi funksional për zhvillimin, përkrahjen, mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarive zejtare, si veprimtarit të pavarura ekonomike me qëllim të realizimit të fitimit në prodhim, qarkullim, shërbimeve në treg dhe artizanatit si lloji i veçant i industrisë.
Shkaqet	<p>Mungesë e dispozitave të qarta ligjore të cilat rregullojnë fushën e zejtarisë dhe artizanatit dhe moskompletim i ligjit me akte nëligjore;</p> <p>Vendosja e barrierave përmes sistemit uniform të licencave për ushtrimin e veprimtarisë zejtare apo artizanate për të gjithë zejtarët pa përjashtime apo lehtësime për veprimtari të veçanta,</p> <p>Mungesa e ndëveprimit të mekanizmave institucional (<i>Ministritë; Komunitat dhe Odat</i>) dhe e ndarjes së përgjegjësive të tyre të cilët përfshihen në dhënien lejeve të punës proces ky i cili përcillet nga një program arsimimi profesional;</p> <p>Mungesa e dispozitave për themelimin e sistemit/platformës digjitale për krijimin e regjistrit dhe licencave për subjektet zejtare;</p> <p>Mungesa e dispozitave të cilat rregullojnë me saktësi sistemin e organizimit, mandatimit dhe funksionimit të Odave/Shoqatave të cilat përfaqësojnë subjektet zejtare dhe artizanate.</p>
Efektet	<p>Është rrezikuar ruajtja e teknikave tradicionale të zejtarisë dhe artizanatit si trashëgimi kulturore;</p> <p>Mungesa e vendosjes së standardeve të kontrollit të cilësisë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve dhe shërbimeve zejtare dhe artizanate;</p> <p>Mungesa e praktikave të qëndrueshme dhe të përgjegjshme për prodhim që parandalojnë degradimin e mjedisit;</p> <p>Mungesa e sigurisë dhe mirëqenies së zejtarve ka promovuar praktika të padrejta të të bërit biznesit.</p> <p>Mungesë e kualifikimit bazuar në kërkesat e tregut të punës;</p> <p>Pamundesia e njohjes dhe vlerësimit të kontributeve kulturore të artizanëve dhe industrisë artizanate;</p>

Ligji për zejtarinë hartohet për arsye si në vijim:

- Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e industrisë artizanate:

Ligji për zejtarinë siguronë një kornizë ligjore për të mbështetur dhe inkurajuar rritjen industrinë artizanate duke ofruar grante, subvencione dhe stimuj të tjerë për zejtarët dhe bizneset.

- Për të mbrojtur interesat e personave të cilët merren me artizanatin:

Ligji për zejtarinë përcakton rregulla specifike që garantojnë sigurinë dhe mirëqenien e zejtarve. Kjo përfshinë sigurimin e mbrojtjes ligjore për artizanët kundër shfrytëzimit dhe konkurrencës së pandershme.

- Për të ruajtur teknikat tradicionale të zejtarisë:

Ligji për zejtarinë rregullon ruajtjen e teknikave tradicionale të zejtarisë dhe vendosë masa për të mbrojtur të drejtat e artizanëve dhe pronësinë e tyre intelektuale.

- Për të rregulluar prodhimet zejtare:

Ligji për zejtarinë vendosë standarde të cilësisë, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit që duhet të përmbushen në prodhimet zejtare.

- Për të promovuar vlerën e kulturës lokale:

Zejtaria është pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe ligji ndihmon në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie kulturore.

Ligji rregullon çështjet themelore të zejtarisë, si konceptin dhe llojin e zejtarisë, kushtet për kryerjen e veprimtarisë zejtare, edukimi dhe trajnimi për kryerjen e zanateve, organizimi, mbikëqyrja dhe masat administrative.

Ky ligj shkon një hap më tej dhe siguron zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit dhe reformimit për kryerjen e zanateve nëpërmjet rregullimit të fushës së zejtarisë dhe në këtë mënyrë të lehtësojë aktivizimin më të shpejtë të rinjve në tregun e punës, si dhe përmirësimin dhe modernizimin e arsimit profesional në Republikën e Kosovës.

Miratimi i kuadrit ligjor të ri bëhet me qëllim të themelimit të sistemit dhe funksionimit të të njësisë se veçantë për zejtarinë në kuadër të Odes Ekonomike të Kosovës e cila do të ndihmojë qëndrueshmërinë e saj, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve që u ofron zejtarëve.

Njësisa e veçantë për zejtarinë në kuadër të Odes Ekonomike të Kosovës e cila do të themelohet sipas këtij ligji do të ketë ndikim të pavarur profesional dhe afarist. Modeli i propozuar njihet edhe si një nga modelet në një pjesë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe analizat kanë treguar se anëtarësimi në Odë siguron përdorimin e një sërë shërbimesh dhe arritjen e qëllimeve që nuk mund të arrihen në mënyrë të pavarur pa mbështetjen institucionale të Odës, e cila përdoret në bazë të parimit të solidaritetit.

Njësisa e veçantë për zejtarinë në kuadër të Odes Ekonomike të Kosovës ushtron kompetencat publike të përcaktuara me ligj:

- *Lëshimi i lejes (licencës) për zejtarin dhe personin fizik që kryen praktikën në pajtim me ligjin.*

- *lëshimi i vërtetimit/certifikatës të dhënies së provimit të kualifikimit profesional*

- *lëshimi i certifikatës artizanit (mjeshtrit)*

- *lëshimi i certifikatës së produktit artizanat.*

Regjistrimi dhe licencimi i ndihmojnë autoritetet të rregullojnë dhe mbikëqyrin prodhimin dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve zejtare. Kjo siguron që produktet të jenë të sigurta dhe konsumatorët të mbrohen nga produktet e dëmshme.

Me ligjin e ri do të rregullohet ushtrimi i veprimtarive zejtare, pasi i mundëson Qeverisë së Republikës së Kosovës të përcaktojë me rregullore se cilat janë ato veprimtari zejtare për të cilat kërkohet një kualifikim i caktuar profesional dhe i atyre për të cilat kjo nuk kërkohet, duke mundësuar që kushtet e kualifikimit të ushtrimit të veprimtarive artizanate të rregullohen në mënyrë të ngjashme siç është në shumicën dërrmuese të vendeve të BE-së.

Krahasimi i kushteve për të hyrë në zeytari në 25 shtetet anëtare të BE-së, vetëm një vend nuk ka kushte të caktuara kualifikimi, dhe dy i kanë ato vetëm në mënyrë të jashtëzakonshme - indirekte. Në vendet e BE-së, ku përcaktohen kushtet kualifikuese për ushtrimin e një aktiviteti zeytar, është tipike që këto kushte vendosen përgjithësisht vetëm për aktivitetet që mund të:

- *të rrezikshme për shëndetin ose pronën e personave,*

- *të rrezikshme për ndotjen e mjedisit.*

Ligji përcakton kushtin e kualifikimit (kualifikimin e duhur profesional) për të gjitha aktivitetet zejtare, çka nënkupton se Qeveria e Republikës së Kosovës përcakton kualifikimin profesional për kryerjen e veprimtarive individuale me akt nënligjor. Ky kusht është i nevojshëm dhe i arsyeshëm për të vendosur kriteret për kryerjen e veprimtarive zejtare të krahasueshme me mesataren e atyre në BE, për të mundësuar ushtrimin me të lehtë të veprimtarisë zejtare dhe duke siguruar kështu edhe kushtet për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj pjese të rëndësishme e ekonomisë. Gjithashtu përcaktimi i aktiviteteve të ngjashme me zeytarinë është kompetencë ekskluzive e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe është e nevojshme që lista e këtyre aktiviteteve të koordinohet me njësinë e veçantë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës.

Me ligj rregullohet niveli i kualifikimeve të nevojshme profesionale për kryerjen e veprimtarive zejtare, të cilat do të përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës me rregullore, përkatësisht nga kërkesa minimale aktuale. Kjo nderlidhet dirket duke ulur më tej kërkesat për marrjen e licencës zejtare, në përputhje me kualifikimin profesional kombëtar në pajtim me **aktin për kualifikimet profesionale kombëtare.**

Gjithashtu edhe harmonizimi me Ligjin për Kundërvajtje është rezultat i ligjit të ri.

Tabela 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palëve me interes	Shkaku (et) me të cilat lidhen palët e interesit	Efekti (et) me të cilat lidhen palët me interes	Mënyra në të cilën palët e interesuara lidhen me këto shkaqe ose pasoja
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë			Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit dhe politikave në fushën e zejtarisë
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit			Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është përgjegjëse për hartimin e kurrikulave të arsimimi dhe aftësimi profesional
Oda Ekonomike e Kosovës			Regjistri zejtar dhe licencat
Shoqatat Zejtare dhe Artizanate			Përfaqësimi i subjekteve zejtare
Subjektet Zejtare dhe Artizanate			Impakti i ligjit të ri

Kapitulli 2: Objektivat

Tabela 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi i përgjithshëm	Emri i dokumentit relevant planifikues
Hartimi dhe zbatimi kornizës ligjore të qëndrueshme dhe funksionale në fushën e zejtarisë dhe artizanatit përmes së cilës synojmë mbrojtjen e interesave të zejtarve.	<i>Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH)2023-2025.</i>
Objektivi strategjik - Krijimi i një sistemi funksional për zhvillimin, përkrahjen, mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarive zejtare me qëllim të një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues;	Plani Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2023-2025.
<p>Objektivat specifike:</p> <p>Objektivat specifike janë rezultat i analizës së bërë për qëllimet e këtij Koncept Dokumenti.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. Krijimi i kuadrit ligjor që mbështet dhe nxit zhvillimin e zejtarisë dhe industrisë artizanate; 1.2. Krijimi i mekanizmave institucional dhe ndarja e përgjegjësive në fushëveprimtarinë e zejtarisë dhe artizanatit; 1.3. Zhvillimi i një sistemi për mbështetjen e zejtarisë dhe artizanatit; 1.4. Arsimi dhe aftësimi profesional në fushën e zejtarisë; 1.5. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike për zejtarinë; 1.6. Informimi i vazhdueshëm i zejtareve. 	<i>Në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, kemi shtyllën e parë të strategjisë që si objektivi kryesor ka 1. Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.</i>

Kapitulli 3: Opsionet

Grupi punues ka shtjelluar problemin kryesor të identifikuar dhe analizuar në këtë koncept dokument dhe ka trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit të identifikuar më lartë dhe arritjen e objektivave.

Këto opsione janë:

- 1) opsioni pa asnjë ndryshim;**
- 2) opsioni për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave ligjore në fuqi;**
- 3) opsioni që parasheh ndryshime ligjore - hartimin e ligjit të ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatin.**

3.1 Opsioni i parë është që të vazhdohet me zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore aktuale në fushën e zejtarisë.

Opsioni pa ndryshime, ruan gjendjen aktuale duke vazhduar moszbatueshmeria e ligjit në fuqi të shtjelluar me këtë koncept dokument. Sistemi do të vazhdoj të ketë mungesë të fuqisë ligjore të mjaftueshme dhe të nevojshme për të adresuar zgjidhjen e problemeve të identifikuara dhe nuk do të mundësoj ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e zejtarisë dhe zhvillimin ekonomik dhe social.

Barra administrative e përcaktuar me ligjin aktual, konsiderohet si ngarkesë e tepërt për zejtarët, të cilët përgjithësisht karakterizohen me burime të kufizuara për ushtrimin e veprimtarisë zejtare. Në mënyrë specifike, licencat shtesë, lejet, tarifat dhe ngarkesat janë në kundërshtim me logjikën e krijimit të një mjedisi të favorshëm për aktivitetin zejtar në Kosovë. Si i tillë, ky opsion nuk mund të mbetet si alternativë, duke u bazuar në problemet dhe mangësitë e shumta sa i takon fushës së zejtarisë. Dispozitat e Ligjit për Zejtarinë, mbivendosen me legjislacionin që ka të bëjë me regjistrimin e biznesit, tregtinë e brendshme, kërkesat teknike, licencat dhe lejet, lirinë e asociimit, kualifikimet profesionale, mbikëqyrjen, dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore etj.

3.2 Opsioni i dytë është ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore në fuqi;

Ky opsion është analizuar në përpjestim të drejtë me masën e problemeve kryesore që janë përshkruar në kapitullin përkatës. Ndërhyrjet me këtë ligj janë të pamundura, një pjesë e konsiderueshme e dispozitave të Ligjit mbivendosen me mbi njëzet akte ligjore dhe nënligjore aktualisht në fuqi në Kosovë. Qëllimi i deklaruar i ligjit është i paqartë, duke shkelur parimin e qartësisë në legjislacion. Në disa raste, kapituj të tërë të Ligjit - p.sh., regjistrimi i biznesit dhe çregjistrimi/ndërprerja e veprimtarisë janë të mbuluar me legjislacion tjetër, siç është Ligji për Shoqëritë Tregtare. Përveç kësaj, dispozitat e tjera specifike të zëvendësuara, përfshijnë, ndër të tjera, kërkesat teknike dhe mjedisore, lejen e punës, aktivitetet e përbashkëta, arsimimin dhe zhvillimin profesional dhe organizimin e aktiviteteve zejtare. Fakti që Ligji është i vjetër konfirmohet edhe nga referencat e tij në IPVQ, andaj konsiderojmë se ky opsion është i

pamjaftueshëm për ti realizuar qëllimet, objektivat strategjike dhe specifike të përcaktuara në këtë koncept dokument.

3.3 Opsioni i tretë që parasheh ndryshime ligjore - hartimin e ligjit të ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit, i cili është edhe opsioni i rekomanduar

Ky opsion është i rekomanduar nga grupi punues për koncept dokumentin. Përmes këtij opsioni synohet të arrihet ndryshimi i politikave ekzistuese. Ligji i ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit do të rregullojë çështjet e mëposhtme të dala nga analiza e këtij koncept dokumenti:

- Perkufizimi i termave: “Zejtari”, “Zeje artizanate”, “Zejtar”, “Produkt artizanat” dhe “transferim i njohurive artizanate”;
- Aktivitetet profesionale që kërkojnë trajnim profesional të përshtatshëm;
- Arsimi dhe aftësimi profesional;
- Kushtet për marrjen e licencës zejtare;
- Ushtrimi i veprimtarie artizanate;
- Përfundimi i vlefshmërisë së lejes zejtare dhe ndalimi i aktiviteteve;
- Regjistri zejtar;
- Themelimi, organizimi dhe funksionimi i njësisë së veçantë në kuadër të Odes Ekonomike të Kosovës;
- Kushtet për njohjen e kualifikimeve profesionale qytetarëve të shteteve për të cilat ka marrveshje multilaterale ose bilaterale dhe vendeve të BE-së për dhe për kryerjen e aktiviteteve profesionale;
- Ruajtja dhe zhvillimi i artizanatit;
- Titullin zejtar i njohur (artizan/mjeshër) i cili dëshmohet me certifikatë e njohur artizanale e lëshuar nga Oda Ekonomike për skemen përkatëse artizanate;
- Mbrojtja e produkteve artizanate (tradicionale) përmes komisionit të vlerësimit të produkteve artizanale;
- Industria artizanate;
- Pergatitja e masave mbështetëse për subjekteve zejtare;
- Hartimi i programit për ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit;
- Masat dhe procedurat e financimit;

Ky koncept dokument propozon hartimin e ligjit për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit pasi që trajton fusha kyçe si të drejtat e zejtarve, standardet, trajnimin dhe qasja në treg dhe në kuadër të Opsionit 3 do të përmbledhën dhe rregullohen edhe çështjet si në vijim:

- Njohja dhe Mbrojtja e Artizanatit:

Ligji i ri për zejtarinë do të përcaktonte kriteret dhe procesin për njohjen dhe regjistrimin zyrtar të zejtarve. Ai do të përcaktojë të drejtat dhe përfitimet që u ofrohen zejtarëve të regjistruar, duke përfshirë sigurimet shoqërore, stimujt tatimorë dhe mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme. Ligji do të vendoste gjithashtu mekanizma për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet zejtarve.

- Standardet e artizanatit dhe kontrolli i cilësisë:

Ligji i propozuar do të përshkruajë standardet dhe rregulloret që duhet të plotësojnë produktet artizanale për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e konsumatorit.

- Edukimi dhe praktika në zejtari:

Për të mbështetur zhvillimin e zejtarëve të ardhshëm, Ligji për zjtarinë përcakton rëndësinë e programeve të edukimit dhe praktikës në zejtari, duke inkurajuar shkollat dhe qendrat e aftësimi profesional që ofrojnë programe të specializuara artizanate, duke nxitur transferimin e aftësive tradicionale të artizanatit tek brezi i ri. Ligji do të ofrojë gjithashtu stimuj për artizanët për të marrë praktikantë dhe për të krijuar programe mentorimi.

- Qasja dhe promovimi në treg:

Ligji për zejtarinë krijon mekanizma për të lehtësuar qasjen e zejtarve në treg, si brenda dhe jashtë vendit. Inkurajon organizimin e panairove artizanate, festivaleve dhe ekspozitave për të promovuar pamjen dhe shitjet e produkteve artizanate. Ligji do të mbështeste gjithashtu zhvillimin e platformave të tregtisë elektronike dhe tregjeve online për të lidhur artizanët me një bazë më të gjerë konsumatore.

- Mbështetja financiare dhe financimi:

Duke njohur kontributin ekonomik të sektorit zejtar, Ligji i ri do të ofrojë mbështetje financiare për zejtaret dhe artizanët. Kjo mund të përfshijë grante, subvencione që synojnë mbështetjen e bizneseve zejtare dhe artizanale.

Andaj bazuar në atë që u tha më lartë Opsioni 3 mbetet opsioni i rekomanduar i cili synon të krijojë një kuadër ligjor gjithëpërfshirës që promovon dhe mbështet zejtarinë në vend. Duke njohur dhe mbrojtur të drejtat e artizanëve, duke garantuar cilësi dhe standarde, duke investuar në arsim dhe akses në treg. Ligji inkurajon praktika të qëndrueshme të cilat kontribuojnë në rritjen dhe qëndrueshmërinë e sektorit artizanat në Republikën e Kosovës.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve në të ardhmen

Tabela më poshtë rendit ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Aneksat 1 deri 4 tregojnë vlerësimin e të gjitha ndikimeve ekonomike, sociale, mjedisore por edhe ndikimet në të drejtat themelore. Këto ndikime paraqiten në Doracakun për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve. Të katër aneksat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Tabela 6. Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara sipas kategorisë së ndikimit

Kategoria e ndikimeve të mundshme	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Ndikimet ekonomike	Ndikimi negativ pasi ligji në fuqi është plotësisht jo funksional	Ndikim i kufizuar, përmirësim relativisht i vogël i efikasitetit të sistemit të pandryshuar.	Rregullimi i kornizës ligjore për fushën zejtarisë dhe artizanatit jep sinjal pozitiv për ekonominë.
Ndikimet sociale	Të drejtat e zejtarve, produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët cenohen nga <i>status quo</i> -ja	Të drejtat e zejtarve, produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët përmirësohen pak nga zbatimi më i mirë, i cili nuk është në nivelin e kërkuar	Të drejtat e zejtarve, produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët, mjedisi, aftësimi profesional, mbikëqyrja konkurrenca e drejte, rregullohen në nivelin e duhur
Ndikimet mjedisore	Ndikim negativ	Ndikim i vogël	Ndikim pozitiv
Ndikimet në barrën administrative	Barra administrative mbetet e pandryshuar në <i>status quo</i> , edhe pse ligji nuk ka qenë i zbatuar	Barra administrative mbetet e pandryshuar në <i>status quo</i> për nga organizimi i funksionimit të zejtarisë, nga mbivendosja e dispozitave me ligje tjera	Barra administrative është zvogëluar për shkak të organizimit të përmirësuar të zejtarisë dhe artizanatit, pasi do të lëshohen licenca vetëm për një numër të kufizuar të veprimtarive zejtare
	Pa ndikim për NVM	Ndikimi i pamjaftueshëm për	Ndikimi pozitiv në NVM për shkak të

Ndikimi në NVM		NVM në eliminimin e praktikave të padrejta tregtare	përmirësimin të funksionimit dhe organizimit të subjekteve zejtare, nder të tjera duke eliminuar praktikën e padrejta tregtare
Ndikimi në buxhet	Opsioni 3 ka kosto buxhetore të kufizuara dhe ndikon në buxhetin vjetor të Kosovës.		

4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Nuk janë hasur vështirësi gjatë hartimit të këtij Koncept Dokumenti për sa i përket mbledhjes së të dhënave dhe informatave tjera relevante, Grupi punues ka marrë për bazë të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në Vlerësimin Ex-Post i Ligjit Nr.2004/44 për Zejtarinë i realizuar nga USAID, Programi për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë, sipas kërkesës së Departamentit Ligjor MINT, dt.24 Shtator 2021.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Në përputhje me Rregulloren 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, ky proces kryhet përmes metodave të ndryshme, përfshirë Platformën Elektronike për Konsultimet Publike dhe përmes takimeve të drejtpërdrejta me palët e interesit, me të gjitha institucionet dhe kategoritë e shoqërisë, qofshin ato me nivele të larta interesi ose ata që mund të japin kontributin e tyre për shqyrtimin e opsioneve. Kontribute të rëndësishme mund të jepen prej të gjitha kategorive të bizneseve, institucioneve të Kosovës që u shërbejnë bizneseve dhe konsumatorëve, odave ekonomike me anëtarë nga radhët e bizneseve dhe ekspertët e projekteve të ndryshme ndërkombëtare për asistencë teknike.

Tabela 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të realizuara për koncept dokumentin

Procesi i konsultimit synon:						
<ul style="list-style-type: none"> - Të merr të gjitha pikëpamjet nga palët që kanë qenë dhe janë përfshirë në zbatimin e ligjit ekzistues, duke filluar nga problemet, efektet që janë shkaktuar në praktikë si dhe ndryshimet që duhet të përfshihen për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. 						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/ Njoftimi	Afati kohor	Buxheti	Personi përgjegjës
Takimi brenda institucional	Përzgjedhja e anëtarëve të grupit të punës	Finalizimi i draftit të parë të Koncept Dokumentit	Komunikimi përmes postës elektronike për organizimin e takimeve	Nëntor 2023	Të përcaktohet	Gurakuq Kastrati
Takimet e grupit punues për hartimin e Koncept Dokumentit	Anëtarët e grupit punues për hartimin e Koncept Dokumentit	Grup punues shqyrton draftin e parë të Koncept Dokumentit	Komunikimi përmes postës elektronike për organizimin e takimeve	06.04.2023 24.08.2023 29.08.3023 05.09.2023 22.09.2023 11.10.2023 12.10.2023 13.10.2023	Të përcaktohet	
Takim i hapur për të gjithë palët e interesit	Të gjitha palët e interesit	Takim publik për të prezantuar draftin e parë	Komunikimi përmes ueb faqes së Ministrisë, njoftimit për	14.11.2023	Të përcaktohet	

		të Koncept Dokumentit	shtyp dhe postës elektronike			
Konsultimi ndërministror	Ministrinë dhe agjencitë përkatëse të linjës	Shpërndahe drafti i parë i plotë	Komunikimi përmes postës elektronike; drafti është së paku në dy gjuhë	Nëntor 2023	Të përcaktohet	
Konsultime publike	Të gjithë hisedarët	Publikimi i konsultimeve në portalin për konsultim publik	Publikimi në ueb faqe; njoftimi me email dhe media sociale	Dhjetor 2023	Të përcaktohet	
Takimi i Grupit të Punës	Anëtarët e grupit punues	Finalizimi i koncept dokumentit	Dorëzimi i Koncept Dokumentit për miratim në Qeveri	18.01.2024	Të përcaktohet	

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Duke pasur parasysh që opsionet janë paraqitur në detaje në Kapitullin 3, kjo pjesë do të trajtojë shkurtimisht përparësitë dhe mangësitë e opsioneve në kontekst. *Opsioni "Pandyshim"* nuk është i mundur të implementohet për shkak të ndryshimeve ligjore të ndodhura kryesisht legjislacionit për tregtinë e brendshme dhe atij për shoqëritë tregtare.

Opsioni 2: Veprimet në kuadër të Opsionit 2 janë të pamundura, pasi një pjesë e konsiderueshme e dispozitave të Ligjit mbivendosen me mbi njëzet akte ligjore dhe nënligjore aktualisht në fuqi në Kosovë, përfshirë qëllimin, definicionet dhe mekanizmat e përfshirë në procesin e zbatimit. Gjithshatu edhe mungesa e akteve nënligjore të cilat rregullojnë përcaktimin e veprimtarive zejtare dhe artizanate, çështja e regjistrave dhe procesi i licencimit duhet të kenë referencë të saktë në legjislacionin primar. Gjithashtu është rregullimi dhe funksionimi i odave të tilat përfaqësojnë bizneset duhet të kete cartësi ligjore cka nuk është e rregulluar në ligjin aktual. Të gjitha këto mangësi është e pamundshme të trajtohen në kuadër të plotësim ndryshimit, cka rezulton se zbatimi i Opsioni 2 është veshtirë i realizueshëm pasi kërkon ndryshimin e pothuajse të 60% të dispozitave të ligjit në fuqi.

Opsioni 3: Ka disa arsytetime për hartimin e ligjit të ri për zejtarinë:

1. Përfitimet ekonomike: Zejtaria dhe industria artizanate ka potencial për të krijuar vende pune, për të stimuluar ekonominë vendore dhe për të gjeneruar të ardhura. Duke mbështetur dhe promovuar zhvillimin e zejtarisë dhe industrisë artizanate, ligji sjellë përfitime ekonomike, si rritja e mundësive të punësimit.
2. Ruajtja e trashëgimisë kulturore: Zejtaria është pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore. Ligji për zejtarinë dhe artizanatin ndihmon në ruajtjen e teknikave dhe produkteve tradicionale të artizanatit, si dhe në promovimin e artizanateve përmes panairëve.
3. Kontrolli i cilësisë: Ligji vendosë standarde të kontrollit të cilësisë për të siguruar që zejet e prodhuara përmbushin disa standarde të cilësisë. Kjo mund të ndihmojë në mbrojtjen e reputacionit të industrisë artizanate dhe parandalimin e shitjes së produkteve nën standarde apo të pasigurta.
4. Mbrojtja e mjedisit: Ligji përcakton se prodhimet zejtare nuk lejohet të kenë ndikime mjedisore, pasi që vendosë standarde mjedisore që duhet të plotësohen duke promovuar kështu praktika të qëndrueshme dhe të përgjegjshme prodhimi.
5. Mbrojtja dhe siguria: Ligji i vendosë rregulla të cilat mbrojnë të drejtat e zejtarëve dhe siguron mirëqenien e zejtarëve si dhe promovon praktikën e drejta të biznesit.

Në përgjithësi ligji siguron një kornizë ligjore për nxitjen e rritjes ekonomike, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, sigurimin e cilësisë, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e mbrojtjes dhe sigurisë në industrinë artizanate, duke e bërë atë një nismë të justifikuar.

Tabela 8. Krahasimi i opsioneve

	Metoda e krahasimit: Analiza shumë-kriterëshe (ASHK)								
Opsionet	Opsioni 1: Pa ndryshime			Opsioni 2: Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore/Ligjit			Opsioni 3: Hartimi i Ligjit për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit		
Rezultati pozitiv relevant	Nuk ka kosto			Nuk ka kosto				
Rezultatet negative relevante	Vazhdojnë mangësitë ligjore dhe zbatimi joefektiv të ligjit			Zbatim më i mirë i ligjit në krahasim me opsionin <i>status quo</i> ; megjithatë, ligji i ndryshuar nuk mbulon të gjitha mangësitë ligjore			Rezultati negativ minimal nëse zbatimi i rregullave të përditësuara është joefektiv		
Kostot relevante	Nuk ka kosto shtesë			Kosto financiare shtesë me rregulla dhe zbatime të kufizuara të përmirësuara			Kosto financiare shtesë me rregulla dhe zbatime të përmirësuara		
Vlerësimi i ndikimit të pritur në buxhet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
				x	x	x	x	x	x
Përfundimi	Nuk ka përfitime dhe nuk ka kosto			Ofron përfitime të vogla pozitive me një kosto më të lartë			Ofron përfitime të mëdha me kosto të përshtatshme		

6.1. Plani i zbatimit për opsionin e preferuar

Duke pasur parasysh përshkrimin e hollësishëm të sfidave që Opsioni 3 synon të shtjellojë, si dhe përfitimet pasuese nëse miratohet opsioni 3, kjo pjesë përqendrohet në planin e zbatimit për hartimin e Ligjit të veçantë për zejtarin dhe artizanatit

Tabela 9: Plani i Zbatimit për Opsionin 3: Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Ligjit për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit

Qëllimi i politikës	Hartimi, miratimi dhe zbatimi kornizës ligjore të qëndrueshme dhe funksionale në fushën e zejtarisë dhe artizanatit përmes së cilës synojmë mbrojtjen e interesave të zejtarëve.							Shifra e vlerësuar e kostos
Objektivi i strategjik	Rregullimi i kornizës ligjore dhe institucionale në fushën e zejtarisë. Ndërtimi i një mjedisi biznesi të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues;							
Objektivi specifik 1: Krijimi i kuadrit ligjor që mbështet dhe nxit zhvillimin e zejtarisë dhe industrisë artizanate ;	Produkti 1.1	Ligji për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit, i miratuar;						
		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni përgjegjës	
	Themelimi i grupit punues dhe hartimi i ligjit	x					MINT	8,000
	Konsulti me ndërministore	x					MINT	500
	Konsulti publik përmes platformës përkatëse online	x					MINT	1500
	Përgatitja e materialeve për miratim të Qeverisë	x					MINT	500
	Informimi i palëve	x					MINT	3500

		të interesit lidhur me ligjin.								
	Produkti 1.2	Aktet nënligjore dhe listat për veprimtarine zejtare, kualifikimet profesionale, të miratuara								
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni përgjegjës		
		Themelimi i grupit punues dhe hartimi i akteve nënligjore		x				MINT	3,000	
		Konsulti me ndërministrorë		x				MINT	500	
		Konsulti publik përmes platformës përkatëse online		x				MINT	1500	
		Informimi i palëve të interesit lidhur me ligjin.		x				MINT	1500	
Objektivi specifik 2: Krijimi i mekaniz	Produkt 2.1	Njësia e vecantë në OEK, e themeluar dhe funksionalizuar								

			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
mave institucionale dhe ndarja e përgjegjësisive në fushëveprimtarinë e zejtarisë dhe artizanatit;		Zhvillimi i strukturës organizative		x					1000
		Rekrutimi i stafit shtesë		x	x				2x33000
		Inventarizimi		x					3000
		Hartimi i planit për ngritjen e kapaciteteve dhe zbatimi i tij							10000
Objektivi specifik 3: Zhvillimi i një sistemi për mbështetjen e zejtarisë dhe artizanatit;	Produkti 3.1	Skemat për mbështetjen e zejtarisë, funksionale (MINT)							
		3.1.1 Hartimi dhe zbatimi i Programit			x	x			
		Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i skemave mbështetëse për zejtarinë			x	x	x	MINT/KESA	300000

Objektivi 4: Arsimi dhe aftësimi profesional në fushën e zejtarisë;	Produkti 4.1	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (MINT/MASHTI), e përditësuar							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
		Harmonizimi i aktiviteteve dhe profesionale të zejtarisë me Kornizën			x				5000
		Zhvillimi i programeve për aftësim profesional nga OEK			x				7000
Objektivi specifik 5: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike për zejtarinë;	Produkti 5.1	Platforma digjitale, e krijuar (OEK)							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
		Dizajnimi i shërbimeve publike në linjë me kërkesat e LPPA		x					5000
		Zhvillimi dhe mirëmbajtja e platformës		x	x	x			50000
		Trajnimi i zyrtarëve për operim			x				5000

		me platformë							
Objektivi specifik 6: Informimi i vazhdueshëm i zejtareve.	Produkti 6.1	Kampanjë gjithëpërfshirëse e komunikimit, e realizuar (MINT/KIESA)							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5		
		Takime me komunitet e zejtarisë dhe shoqatave				x			5000
		Organizimi dhe pjesëmarrja e panairëve/ekspozitave për produkte artizanate KIESA				x			50000

Kapitulli 7: Përfundimi dhe hapat e ardhshëm

Bazuar në gjetjet e lartëcekura, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Departamenti i Ndërmarrësisë si hartues i këtij Koncept Dokumenti i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratoj Opsionin 3, me të cilin propozohet hartimi i Ligjit të ri për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit.

Në përgjithësi, ligji për zejtarinë, ruajtjen dhe zhvillimin e artizanatit në Republikën e Kosovës synon të nxisë zhvillimin e zejtarisë dhe industrisë së artizanatit, ruajtjen e zejtarisë tradicionale, inkurajon inovacionin dhe siguronë zbatimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë. Ligji gjithashtu siguron një kuadër ligjor që mbështet zejtarinë dhe inkurajon bashkëpunimin midis palëve të interesit për të promovuar zhvillimin e zejtarisë dhe artizanatit në Republikën e Kosovës.

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë do të ndërmarrë procedurat e nevojshme për të hartuar ligjin, në përputhje me parimet dhe zgjidhjet e propozuara.

7.1: Dispozitat për monitorim dhe vlerësim

Pas miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ligji i ri pritet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës deri në fund të vitit 2024.

Aneksi 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik¹

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë / i ulët	I lartë / i ulët	
Vendet e punës ²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	x			I ulët	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ndikojë në lehtësinë e gjetjes së punës?		x			
Të bërit biznes	A do të ndikojë në qasjen në financa për bizneset?		x			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?	x		I ulët	I ulët	
	A do të lejohen produkte të caktuara në treg?		x			
	A do të mbyllen bizneset?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?		x			
Barra administrative	A parashihen obligime që bizneset të ofrojnë informata të reja?		x			
	A është thjeshtëzuar obligimi për të ofruar informatat e biznesit?	x		I lartë	I ulët	
Tregtia	A pritet të ndryshojnë rrjedhat aktuale të importit?		x			
	A pritet të ndryshojnë rrjedhat aktuale të eksportit?		x			
Transporti	A do të ndikojë në mënyrën e transportimit të udhëtarëve dhe / ose mallrave?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të		x			

¹ Legjisllacioni i ri përmirëson dhe thjeshtëson mjedisin ligjor dhe institucional, por në përgjithësi, përmirësimi statistikor besohet të jetë i ulët

² Kur ndikon në vendet e punës, do të ketë edhe ndikime shoqërore.

	transportuar udhëtarë dhe / ose mallra?					
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në aktivitete të reja?	x		I ulët	I ulët	
	A pritet që kompanitë të anulojnë ose shtyjnë investimet për më vonë?		x			
	A do të rriten investimet e Diasporës?		x			
	A do të ulen investimet e Diasporës?		x			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi afarist i produkteve, siç është energjia elektrike?		x			
	A do të ulen çmimi i inputeve të biznesit, siç janë energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa të nxiten inovacioni dhe kërkimi?		x			
	A ka gjasa të pengohen inovacioni dhe kërkimi?		x			
Ndikimi në NVM-të	A janë NVM-të kryesisht në mesin e ndërmarrjeve të prekura?	x		I lartë	I ulët	
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve që janë në dispozicion për bizneset apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për bizneset apo konsumatorët?	x		I ulët	I ulët	
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të preket ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	x		I ulët	I ulët	
	A është i përqendruar ky sektor në ndonjë rajon të veçantë?		x			

Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet në rritjen e ardhshme ekonomike?	x		I ulët	I ulët	
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Aneksi 2: Formulari i vlerësimit të ndikimeve sociale ³

Kategoria e ndikimit social	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë / i ulët	I lartë / i ulët	
Vendet e punës ⁴	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	x		I ulët	I ulët	
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A preken vendet e punës në një sektor të veçantë biznesi?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	x		I ulët	I ulët	
Ndikimet sociale rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në ndonjë rajon ose qytet të veçantë?	x		I ulët	I ulët	
Kushtet e punës	A preken të drejtat e punëtorëve?		x			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet e punës në kushte të rrezikshme? (parashihen standarde më të mira)	x		I lartë	I ulët	
	A do të ketë ndikim në mënyrën e dialogut shoqëror ndërmjet të punësuarve dhe punëdhënësve?		x			
Përfshirja sociale	A do të ndikojë në varfëri?		x			

³ Legjisllacioni i ri përmirëson dhe thjeshtëson mjedisin ligjor dhe institucional, por në përgjithësi, përmirësimi statistikor besohet të jetë i ulët

⁴ Kur ndikon në vendet e punës, do të ketë edhe ndikimet ekonomike.

	A do të ketë ndikim në qasjen në skemat e mbrojtjes sociale?		x			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ketë ndikim në financimin ose organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		x			
Edukimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë ndikim në trajnimin profesional?	x		I lartë	I lartë	
	A do të ketë ndikim në aftësimin e punëtorëve dhe shkollimin gjithë jetësor?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë ndikim në organizimin ose strukturën e sistemit arsimor?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë ndikim në lirinë dhe vetëqeverisjen akademike?		x			
Kultura	A ndikon opsioni në larminë kulturore?	x		I ulët	I ulët	
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x			
	A preken mundësinë për personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë apo të përfitojnë nga aktivitetet kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?	x		I ulët	I ulët	
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin demokratik?		x			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	x		I lartë	I ulët	I ulët

	A do të informohet publiku më mirë për çështje të caktuara?	x		I lartë	I ulët	I lartë
	A ndikon opsioni në mënyrën e funksionimit të partive politike?		x			
	A do të ketë ndikim në shoqërinë civile?		x			
Shëndeti dhe siguria publike	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç janë jetëgjatësia apo norma e vdekshmërisë?		x			
	A do të ndikojë në cilësinë e ushqimit?		x			
	A do të rritet ose zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme? (zvogëlohet)	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës ose cilësisë së ajrit, ujit dhe / ose tokës?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në hedhjen e mbeturinave?		x			
	A do të ketë një ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë niveli i interesimi për sportet, ndryshimet ushqimore ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x			
	A ka grupe specifike që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerët (që përcaktohet nga faktorët siç janë mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grupi shoqëror ose rajoni)?	x		I ulët	I ulët	

Krimi dhe siguria	A ka mundësi të preken kriminelët?		x			
	A preket fitimi i mundshëm nga krimi?		x			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		x			
	A ka ndikim në kapacitetin e zbatimit të ligjit?	x		E lartë	E ulët	
	A ka ndonjë ndikim në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x			

Aneksi 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit mjedisor ⁵

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ndikojë në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj)?	x		E ulët	E ulët	
	A do të ketë ndikim në konsumin e karburantit?		x			
	A do të ndryshojë larmia e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmimet e produkteve që janë miqësore për mjedisin?	x		E ulët	E ulët	
	A do të jenë më pak ndotëse aktivitete të caktuara?	x		E ulët	E ulët	
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?	x		E ulët	E ulët	
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujit të ëmbël?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe përdorimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (siç janë acidifikimi, ndotja, përdorimi i pesticideve ose herbicideve)?		x			
	A do të ndikojë në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbasë terreni (përmes ndërtimeve, etj.)?		x			
	A do të rikuperohet toka (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			

⁵ Legjislacioni i ri përmirëson dhe thjeshtëson mjedisin ligjor dhe institucional, por në përgjithësi, përmirësimi statistikor besohet të jetë i ulët

	A do të ketë ndonjë ndryshim në përdorimin e tokës (p.sh. nga përdorimi pyjor në përdorim bujqësor ose urban)?		x			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat e trajtimit të mbeturinave?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësinë për riciklimin e mbeturinave?	x		I ulët	I ulët	
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervat e peshkut, energjia hidrike, energjia diellore, etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve jo të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri, etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat e rreziqeve, të tilla si zjarre, shpërthime ose aksidente?	x		I ulët	I ulët	
	A do të ndikojë opsioni në gatishmërinë në rast të katastrofave natyrore? A preket mbrojtja e shoqërisë nga katastrofat natyrore?		x			
	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura ose të rrezikuara ose në zonat ku ata jetojnë?		x			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të preken madhësia ose lidhjet ndërmjet zonave natyrore?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
	A do të ketë ndikim në trajtimin e kafshëve?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të preket shëndeti i kafshëve?	x		I ulët	I ulët	
	A do të preket cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			

Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit në të drejtat themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimi ose kostoja e pritur e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, të drejtën e tyre për jetë apo integritetin e një personi?		x			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		x			
	A ndikon opsioni i privatësisë në privatësinë e një personi?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar një familje?		x			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose sociale të individëve ose familjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x			
	A ndikon në lirinë e shprehjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit apo asociimit?		x			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		x			
	A janë të garantuara të drejtat e individit në qasje, korrigjim dhe kundërshtim?	x		I lartë	I lartë	
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x		I lartë	I lartë	

Azili	A ndikon opsioni në të drejtën për azil?		x			
Te drejtat pronësore	A do të preken të drejtat pronësore?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e të bërit biznes?		x			
Trajtim i barabartë	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x		I lartë	I lartë	
	A ka gjasa që grupe të caktuara, të cilat preken në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, mendimit politik ose mendimit tjetër, moshës ose orientimit seksual) të preken në mënyrë direkte apo indirekte?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtën e personave me aftësi të kufizuara?		x			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		x			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të ndërlikuara?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, qasja në ndonjë dosje, etj.)?	x		I lartë	I ulët	
	Për ligjin penal dhe për dënimet e parapara: a preken të drejtat e të pandehurit?		x			
	A preket qasja në drejtësi?		x			

RAPORTI NGA PROCESI I KONSULTIMIT

KONCEPT DOKUMENTI PËR FSHËN E ZEJTARISË

Hyrja/sfondi

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë respektivisht Departamenti i Ndërmarrësisë në cilësinë e Organit Propozues për hartimin e Koncept Dokument për fushën e zejtarisë ka propozuar hartimin e këtij koncepti me qëllim që të rregullimit dhe ngritjes së një sistemi ligjor funksional për zhvillimin zejtarisë në përgjithësi, duke definuar kështu edhe përkrahjen, mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e veprimtarive zejtare, si veprimtari të pavarura ekonomike me qëllim të realizimit të fitimit në prodhim, qarkullim, shërbimeve në treg si dhe artizanatit duke e përkufizuar si një lloji të veçantë i industrisë. Prandaj përmes hartimit të koncept dokumentit për fushën e zejtarisë do të kemi një kornizë ligjore funksionale, përmes të cilës synojmë mbrojtjen e interesave të bizneseve dhe shoqatave të bizneseve në Republikën e Kosovës të cilat operojnë në fushën e zejtarisë. Gjithashtu do të arrijmë përputhshmëri më të lartë të hartimit dhe zbatimit të legjislacionit në përputhje me praktikën dhe standardet/modelet e vendeve të Bashkimit Evropian.

Drafti i koncept Dokumenti është prezantuar me rastin e shënimit të Javës Globale të Ndërmarrësisë me dt. 14.11.2023. Në këtë ngjarje ka marrë pjesë Oda e Zejtarëve të Prizrenit dhe njëzet e pesë biznese të zejtarisë.

Bazuar në Rregulloren Nr.09/2011 të Punës së Qeverisë, Rregulloren nr.13/2013 Për Shërbimin Ligjor Qeveritar, Ministria i ka kaluar hapat e mëposhtëm të procesit legjislativ si: formimin e grupit punues, pjesëmarrjen në disa takime me grupin punues për hartimin e draftit fillestar të koncept dokumentit Koncept Dokument për fushën e zejtarisë të Kosovës dhe pas finalizimit, koncept dokumenti është dërguar për konsultim të palët e interesit.

Departamenti i Industrisë si bartës kryesor i këtij procesi është siguruar që analiza të jetë sa më cilësore dhe të jetë e hartuar në përputhje me standardet dhe rregullat e përcaktuara në Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve.

Ashtu që analiza të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe cilësore, krahas punës kërkimore, janë konsultuar institucionet e tjera relevante të cilat do të përfshihen në implementimin e legjislacionit i cili afekton ligji i ri.

Qëllimi dhe fushëveprimi i konsultimit gjatë hartimit të politikave është me rëndësi që të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e konsultimit të jenë të njohur qysh prej fillimit me qëllimin dhe fushëveprimin e këtij koncepti. Kjo do të ndihmoi Ministrinë për të analizuar gjendjen, identifikimin e problemeve, opsioneve, përgatitjen e rekomandimeve

dhe propozimeve nga palët, për t'i përfshirë gjatë hartimit të Koncept Dokument për fushën e zejtarisë.

Ecuria procesit të konsultimit

Duke pasur parasysh se procesi i konsultimeve është realizuar dhe është zhvilluar konform rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Punën e Qeverisë nr. 09/2011, Rregulloren Nr. 05/2016 Për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Udhëzuesin për procesin e konsultimeve Nr.062/2011 dt. 26.09.2011, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si organ propozues i këtij koncept dokumenti ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike, në të cilën periudhë e ka dërguar në Konsultim të të gjitha institucionet përkatëse dhe shoqatat relevante, në mënyrë që t'iu ofrojmë informata për publikun e në veçanti për grupet e interesit me qëllim që të merret mendimi i publikut dhe grupeve të interesit rreth hartimit të koncept dokumentit.

Kohëzgjatja e procesit të konsultimit të dokumentit në fjalë, është bërë konform Rregullores për Punën e Qeverisë nr. 09/2011.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve të cilët kanë kontribuar
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	09-30.11.2023 15 ditë pune	Dokumenti është përcjell te të gjitha instiucionet dhe zyrat përkatëse ashtu siç përcaktohet me Nenin 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.	Një
3. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	01-22.12.2023 15 ditë pune	I hapur për publikun dhe të gjitha palët e interesit. Komente u pranuan vetëm nga një palë.	Një
5. Takimet publike	14.11.2022	130	0
7. Konferencat			
9. Takime me grupe të interesit			
11. Punëtoritë			
13. Intervistat/takimet sy në sy			
15. Hulumtimet e			

opinionit			
17. Votimi diskutues			
19. Panelet me qytetarë			
21. Stendat në rrugë			
23. Tjetër	Takim me OEK 10.10.2023	5	0

Përmbledhje e kontributeve të pranuar gjatë procesit të konsultimit dhe kategoritë e kontribuesve

Kemi pranuar komente nga Oda Zejtariisë në Prizren:

Hapat e ardhshëm

Pas përfundimit të procesit të konsultimit paraprak dhe konsultimit publik i cili është bërë në pajtim me udhëzuesit dhe standardet përkatëse për konsultime publike të nxjerra në pajtim me RRPQ, zyrtari përgjegjës për hartimin e Koncept dokumentit ia dërgon konceptin drejtorit të Departamentit Ligjor të ministrisë përkatëse i cili nëse nuk ka vërejtje, ia dërgon për shqyrtim dhe miratim Ministrisë përkatëse përmes Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përkatëse.

Tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Emri i organizatës /individit	Koment i organizatës /individit	Përgjigja nga Ministria E pranuar plotësisht E pranuar pjesërisht E refuzuar	Sqarim nga Ministria (veçanërisht arsyet për të mos pranuar komente të caktuara)
ODA E ZEJTARISË PRIZREN (OJQ)	Ne si Odë Zejtariisë në Prizren konsiderojmë se në këtë fazë Qeveria e Kosovës/MINT ta themeloj me Ligj Oden e zejtariisë e cila to të përfaqësoj interesat e zejtariëve.	E refuzuar	Grupi Punues ka vendosur që interesat e zejtariëve të përfaqësohen nga Oda Ekonomike e Kosovës e cila do të themelojë njësinë e veçantë e cila do të mbulojë fushëveprimtarinë siç është përcaktuar me

Emri i organizatës /individit	Koment i organizatës /individit	Përgjigja nga Ministria E pranuar plotësisht E pranuar pjesërisht E refuzuar	Sqarim nga Ministria (veçanërisht arsyet për të mos pranuar komente të caktuara)
			<p>Koncept Dokument</p> <p>OJQ-të të cilat përfaqësojnë interesat e zejtareve si anëtar të tyre do të përfaqësohen nga Këshilli për Zejtarinë i cili do të themelohet nga MINT.</p>
ODA E ZEJTARISË PRIZREN (OJQ)	Organizimi, fushë veprimtaria, lista me profesione,	E Pranuar	Të gjitha janë të përfshira në Koncept Dokument.
ODA E ZEJTARISË PRIZHTINË (OJQ)	Oda e zejtarisë në Prishtinë mbështetë propozimin qe interesat e zejtareve të përfaqësohen nga Oda Ekonomike e Kosovës e në kuadër të të cilës do të themelohet njësinë/Departament e veçantë e cila do të përfaqësoj zejtare siç është përcaktuar me Koncept Dokument	E Pranuar	Është e përfshirë Koncept Dokument

Emri i organizatës /individit	Koment i organizatës /individit	Përgjigja nga Ministria E pranuar plotësisht E pranuar pjesërisht E refuzuar	Sqarim nga Ministria (veçanërisht arsye për të mos pranuar komente të caktuara)